Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
16-03-2022
01-060/01-281

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **II** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **22.03.2022 (e Martë),** në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektit e vjeter të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**2. Shqyrtimi i planit vjetor për vitin 2022 dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimi të Brendshëm të Komunës së Vitisë, për periudhën kohore 2022-2024.**

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike.**

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim te hapësirave dhe mbrojtjen e mjedisit.**

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik draft ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011.**

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale me nr. 00002-3 në zonën kadastrale në Letnicë.**

**8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash.**

**9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022**

**10. Informatë (raport) për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën Janar – Dhjetor 2021.**

**Viti, më 16.03.2022**

**Me respekt!**
**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## NGA MBLEDHJA E PARË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.02.2022 (e Premte),** Zyrën e Konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka. z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, znj. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtoret që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Uroj që të kemi një vit të mbarë! Pasi që është seanca e parë, më lejoni të uroj një vit të mbarë. Desha të ju njoftoj se, të gjitha aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

**znj. Liridona Bslimi:** Përshëndetje për të gjithë! Pasi që është mbledhja e parë, më lejoni të ju uroj punë të mbarë kolegëve dhe ekzekutivit. Pasi që është mbledhja e parë, unë kam disa kërkesa, propozime, që të me sjellën disa informata. Së pari kam një propozim, që në seancën e Kuvendit Komunal të jet prezent psikologu i komunës, pasi që e dimë që ka një kohë të gjatë, edhe e dimë që jemi duke u përball me mungesë të stafit mjekësor. Në disa shkolla kemi pas orare të çrregulluara dhe mendoj që duhet të jet psikologia dhe ta jep një raport, se si ka qenë gjendja në disa shkolla, sepse kemi pas orar të çrregulluar dhe mendoj që të naj sjell një raport psikologia për gjendjen nëpër shkolla; në ato parashkollore dhe fillore. Një kërkesë tjetër, mendoj që duhet, sepse ekziston komisioni për inventarizimin e pasurisë së komunës, mirëpo nuk e dimë se ky komision a është funksional dhe si ka shku puna e tij deri tani. Mendoj që është mirë që, në seancën e radhës të naj sjell një raport, se si qëndron inventarizimi i komunës sonë, pasi që në nuk kemi as një informacion rreth kësaj. Unë po shof që, në ftesë kemi edhe formimin e disa komisioneve, mes tjerash është edhe komisioni për barazi gjinore. Mirëpo ne si LVV e shohim të rrugës, që të bëhet një analizë dhe të formohet një drejtori për të drejtat e njeriut, pasi siç jemi duke e parë, mendoj që kjo është shumë e rëndësishme si shoqëri ta kemi një drejtori të tillë. Mendoj që duhet të vij në rend dite kjo, të krijojmë një drejtori. Edhe çka kam pa në Komunën e Gjilanit dhe të Ferizajt, në këto komuna kanë fillu temat për qentë endacak, ku janë tu bë strehimore për trajtimin e këtyre qenve, ndërsa në komunën tonë nuk kemi informacion se si qëndron kjo. Mendoj që edhe për këtë duhet të vjen pikë e rendit të ditës, ta shofim se çka mujmë me nxjerr nga kjo. Edhe e kërkoj një informacion mbi derivatet e naftës. Dosjen e tenderit të përgatitur nga autoriteti kontraktues, nëse ka mundësi me e specifiku pjesën e çmimeve.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Sa e kuptova unë, Drejtoria e Arsimit ta sjell një informacion rreth punës së psikologes së komunës. Komisioni për inventarizim, këtu e kemi drejtorin e financave, besoj që ky e sjellë këtë informatë. Propozim për një drejtori të re, tani e kemi ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës, sepse drejtoritë

informatë. Propozim për një drejtori të re, tani e kemi ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës, sepse drejtoritë bëhen vetëm me ndryshim të statutit.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Fillimisht më lejoni të ju përshëndetsh, duke ju dëshiruar suksese në këtë mandat. Unë i zura tri çështje që i ngriti këshilltarja komunale. Çështjen e formimit të drejtorisë, e ku e sqaroi kryesuesi i kuvendit, se si krijohet një drejtori. Propozimi vjen nga kryetari i komunës për krijimin e një drejtorie, e në këtë seancë e kemi ndryshim plotësimin e statutit, e ku do ta krijojmë një drejtori të re, atë të Zhvillimit Ekonomik. Ne mund ta bisedojmë që me i kushtu rendësi më shumë Komitetit për Barazi Gjinore, sepse tani edhe me udhëzim administrativ krejt komitetet do të paguhen, e besoj që edhe do të jenë funksional. Qentë endacak. Ne e kemi një kontratë, kanë fillu me trajtimin e kësaj problematike dhe besoj që do të keni informacionin në fund të punës së tyre.

**znj.Liridona Bislimi:** Unë po mendoj, që të diskutojmë për krijimin e drejtorisë, edhe unë besoj që komiteti është më aktiv nëse behet pagesa. Puna e qenve endacak. Nuk po shihet ndonjë gatishmëri për këtë, besoj që do të ishte mirë të jepet një raport për këtë: A janë vaksinuar qentë endacak, a janë trajtuar? etj.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Do ta kish informacionin me kohë për këtë.

**z.Ilir Zuka:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë i kam dy kërkesa, se bashku me Këshillin e Pozharanit, bile kemi dorëzu një kërkesë tek ekzekutivi i komunës. Dijet që nga Kovidi kemi humb shumë njerëz me vlera në Komunën e Vitisë, e një nder ta e kemi edhe doktor Fadil Zuken, kështu që, i propozoj ekzekutivit që, ne mendojmë që tek QMF-ja në Pozharan jemi të interesuar me ja vendos një pllakë përkujtimore doktorit. Po paraprakisht dijet që këto procedura, neve na duhen me pas një leje që me vendos atë pllakë. Dhe çështja e dytë që kisha me ngritë, komisionin për emërtimin e rrugëve, uroj që në këtë mandat ta formojmë këtë komision edhe të punojmë, sepse kemi shumë kërkesa për emërime të rrugëve e të shesheve, e kemi edhe nga Pozharani disa, ku edhe për emërimin e sheshit në Pozharan.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Nënkryetar, tek puna e qenve endacak, për katër vite që kam qenë në asamble, e di që është e specifikuar me udhëzim administrativ, të parashihen mjete buxhetore nga buxheti për trajtimin e qenve endacak, dezinfektimi, dezinsektimin e hapësirave. Që katër vite asnjëherë kjo nuk është bë. Uroj që tani të behet.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

## Rend dite

1. **Pasqyrat financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2021.**
2. **Shqyrtimi i planit vjetor për vitin 2022 dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimi të Brendshëm të Komunës së Vitisë, për periudhën kohore 2022-2024.**
3. **Informatë (raport) vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2021.**
4. **Informatë për planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin 2022.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-731, të datës 24.09.2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e iniciativës së kryetarit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.**
8. **Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim Vendimit për formimin e Komisionit për procedurat e mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë.**
9. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore.**
10. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Arsim, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë.**
11. **Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022.**

**12. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2022.**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm?

**z.Ilir Zuka:** Para disa dite ju ka ardh një kërkesë nga këshilli iniciues dhe familja Tahiri për me fut një pikë të rendit të ditës për ndarjen e një hapësire për një bust për martirin Milahim Tahiri. Unë e kam marr kërkesën që me keshyrë mundësinë që, këtë seancë me shti si pikë të rendit të ditës. Është edhe materiali, krejt çka duhet i duhet një ditë pune Drejtorisë së Katastrit me dal me bë ndarjen edhe me pru si pik të rendit të ditës, sepse nëse nuk e shtim në këtë seancë, kjo shkon edhe dy muaj tjerë. Unë e pash edhe përgjigjen e Drejtorisë së Urbanizmit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Tek ne ka ardh kjo kërkesë. Unë të njëjtën ditë e kam cedu tek drejtorit përgjegjëse. Drejtoritë nuk kanë pru një material që me pas në rend dite, e përderisa unë nuk kam material, nuk muj me parapa në rend dite.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës:** E kam të kjart kërkesën e Ilirit, po e kam mungesë të informacionit të plotë, e nuk po du me bë gabim siç kemi bë në legjislacionin e kaluar, e ku sot gjykata naj ka sjellë një procesverbal që kërkon me e anulu vendimin për Safet Rexhepin, e ku na ka paditë MAPL-ja në Gjykatë, e tash duhet me dal në pozitë të palakmueshme, me e anulu atë vendim. E për këtë nuk po du me u ngut e me ju qit në pozita të palakmueshme, e më mirë po du me e pas materialin me e studiu rastin. Jemi në përfundim të planit zhvillimor komunal.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, para se me qit në miratim rendin e ditës, kërkoj që pika e dytë, për shkak se zyrtari I Zyrës së Auditimit nuk është këtu për shkak të problemeve shëndetësore, kërkoj që këtë pikë të rendit të ditës ta hekmi në këtë seancë e ta lajm për seancën tjetër. A jeni që të miratohet rendi i ditës pa piken e dytë. Me votat e të gjithëve miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

**1. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2021**

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Përshëndetje të nderur të pranishëm! Është e vërtet që jam drejtor i ri, e nuk kam qenë në vitin e kaluar. Për buxhetin komunal janar-dhjetor 2021 të aprovuara kanë qenë 13 milion 410 mije 666 euro e 53 cent, ndërsa alokime kanë qenë 13 milion 410 e 598 e 03 cent, të paalokuara kanë mbetur vetëm 8.5 euro. Shpenzime totale në euro kanë qenë 12 milion e 674 mije e 793 euro e 83 cent ose përndryshe 94.51% e total buxhetit të alokuar, pagat dhe shtesat 94.99%, mallra dhe shërbime 98.33%, komunali 73.73.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ilir Zuka:** Unë nuk kam pyetje për drejtori, vetëm i uroj punë të mbarë.

**znj.Liridona Bislimi:** Drejtorit i uroj punë të mbare! Drejtor, në fillim po kërkoj një informatë për inventarizimin e inventarit. Kish qenë mirë me naj sjellë listën e pasurisë së komunës. Çfarë pasurie ka komuna të luajtshme dhe të paluajtshme. Kërkoj të specifikohen me detaje pasqyrat, tek faqja nr.3, që është pagesa për vendimet gjyqësore, këtu e kërkoj një sqarim,. Shpenzimet e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile; na u ka dok shifer shumë e madhe, prandaj kërkoj një sqarim. Tek shërbimet e ndryshme shëndetësore, edhe për këtë kërkoj sqarim, shërbimet kontraktuese të tjera, edhe për ketë një sqarim. Tek faqe nr.4, furnizim me inventar, është një shumë më se e ngritur, e cila bëhet për çdo vit. Kërkojmë një sqarim. Kodi 13509, pajisje tjera, kërkojmë sqarim. Furnizim për zyre, kodi 13610, kurojmë sqarim. Furnizim me lëndë djegëse, dru. Edhe kjo na ka habit, është shumë, një sqarim për këtë: sa ka qenë çmimi edhe nëpër cilat shkolla janë furnizu. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, edhe për këtë një shpjegim. Mirëmbajtja e ndërtesave. Edhe për këtë kërkojmë sqarim, mirëmbajtja rutinore.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje drejtor! Tek shpenzimet na duhet lista e shpenzimeve, me pas një listë, sepse ne nuk e dimë. Kemi shpenzimet tjera, pajisje tjera që ne nuk e dimë ku kanë shku. Kemi shërbimet kontraktuese, një sqarim për këtë. Tek faqja nr. 4, pajisje të tjera, një sqarim për këtë. Furnizim me ushqim e pije.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Shpenzimet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, nuk e di se cilat lëndë janë, po e di që 5-6 autorizime në ditë i nënshkruaj më shku me na perfaqesu në gjykatë përfaqësuesit e

Drejtorisë së Arsimit. Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile. Këto nuk janë problem edhe në Postë i ki të dhënat për këtë. Tek veturat ju dukë shumë, edhe neve po na duket shumë, po nuk kemi zgjidhje tjetër, jemi tu punu me kerre që i kanë bë 10 -15 vite, aty hyn edhe kerret e zjarrfikësve, QKMF-së. Krejt këto kerre i kanë bë qato shpenzime. E tash aty ku ti ke dyshim, vendose edhe e qojmë procedurën më tutje. Po në përgjithësi janë këto. Çështja e furnizimi me dru. Ne i furnizojmë krejt shkollat, nuk ka përjashtim, e kemi edhe sasinë e drunjëve për çdo shkolle.

**znj.Liridona Bislimi:** Nënkryetar, besoj që e kemi obligim edhe ne edhe ju me kerku sqarime për këto, sepse në këtë formë që na ka ardh nuk është e kjartë.

**z.Jakup Demiri:** Nënkryetar, ne po i kërkojmë disa sqarime jemi tu fol për 13 milion euro buxhet e shpenzimet që ne po i kërkojmë, besoj që duhet me i kerku, sepse unë si këshilltar po du me e ditë se ku kanë shku qato shpenzime, e kërkoj një listë me naj dërgu në kuvend.

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Pasqyrat financiare kam provu me ju pru me nënkode, po nuk kam mujt nuk më lejon Ministria e Financave, kështu që për shërbime tjera, po u ceken lendet gjyqësore janë 2577 lëndë për të cilat gjithmonë është një pranues, një ekzekutues. Lëndët ekzistojnë për pyetjet me drejtoni në email edhe besoj që pa problem ju përgjigjem.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Zakonisht pjesa, shërbimet kontraktuese tjera merr si shprehi. Kjo është pikë më e ndjeshme, i merr informacionet për këtë edhe e sjell në KPF ose ne Kuvend.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

**2. Informatë (raport) vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2021**

**z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit**: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju dëshiroj punë të mbarë e suksese. Materialin e keni marr me kohë, i keni të gjitha shënimet, për çdo pyetje që ju intereson mundemi me diskutu. Po ja jap një përgjigje Liridonës. Në pyetjen e parashtruar më herët, numër 23 e keni kontratën me furnizim me dru, 152 mijë 547 euro është kontrata e vjetër dhe nga kjo kontratë furnizohen 42 njësi buxhetore ose nënbuxhetore të komunës. Kjo kontratë është realizu, ka përfundu çmimi, ka qenë 47.5 për metër hapësirë, ndërsa sasia e druve është 3350. Kjo është thuajase e përhershme, me pak ndryshime, sepse prej krejtve njësive buxhetore, vetëm QMF-ja në Pozharan e ka nxemjen me pelet, të tjerat janë me dru. Sa i përket pyetjes për tenderin me naftë, që 5 vite ka qenë e centralizume edhe gjithherë e ka bë niveli qendror i prokurimit publik, ndërsa tash para një muaji naj ka dhanë të drejtën që ne me e udhëheq procedurën vetëm për një vit, për 12 muaj. Për furnizim me naftë është në procedurë, kjo pritet së shpejti mu nënshkru kontrata.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**znj.Liridona Bislimi:** Unë kam vërejtje tek numrat që janë të renditur. Kemi faqet pa numra, është ngatërresë, me një faqe përfundon nr. 27, madje faqja 28 mungon. Te pasqyrat financiare edhe tek materiali i juaj nuk përputhet numri. Tek lëndët djegëse, kërkoj informacione shtesë. Tek 13, rregullimi i nevojave, disa nga ambulancat e Komunës së Vitisë, për cilat ambulanta është fjala. Tek 20, furnizimi me perde, tepi, tepisona për nevojat e shkollave. Nëse ka mundësi kontratën me naj sjell, se kjo po me intereson. 24, rregullimi i kanalizimit për ambulanten në fshatin Terpezë. Këtu me ma dorëzu kontratën me të specifikuar. Shërbimet e zërimit për nevojat e komunës. 29 pajisjet kundër zjarrit dhe furnizime me aparate të reja. Sa herë ndodhe mushja. 34, asfaltimi i rrugës Viti - Sllatinë e Ulët. A ka fillu puna apo ende nuk ka fillu?

**z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit:** Kemi marr një njoftim nga KRPP-ja, e cila thotë, që t'i eliminoni nga raporti të gjitha kontratat e panënshkruara dhe të gjitha kontratat që janë në procedurë, prandaj për këtë aty mungon renditja. Dallimi tek numrat në pasqyra financiare dhe tek informata qendrën në atë se është bart borxhi nga një vit në tjetrin. Kontratën për perde e ki publike ne web të komunës. Tek aparatet e zjarrit, 2440 euro, me ligj çdo 6 muaj aparatet e zjarrit duhet të mbushen. Këto janë të planifikuara. Te zjarrfikësit, ambulantat, mbushja ndodhe dy herë ne vit. Rruga Viti- Sllatinë është projekt dyvjeçar. Sipas planifikimit buxhetor, kjo tash është pjesa e dytë e asfaltimit. Më herët pjesa e parë ka qenë përmirësimi i infrastrukturës rrugore Sllatinë e

Poshtme –Viti. Kjo fazë është para përfundimit, është në fazën e pranimit teknik, ndërsa këtë kontratë që e kemi lidh është kontrata për me shtu asfaltin, e cila ende nuk ka fillu. Kjo duhet në pranverë me fillu.

**z.Jakup Demiri:** Unë e kame një pyetje, tek 24, rregullimi i kanalizimit për ambulancën ne fshatin Terpezë, kur ka ndodhe ky aktivitet në cilin vit e ne cilin muaj.

**z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit:** Rregullimi i kanalizimit ne ambulanten e fshatit Tërpezë ka ndodhë në vitin 2021, në muajin e 6. Kjo sa kanalizim, po është kyqje e ambulantes në rrejt të kanalizimit qendror. Shuma është 1300 euro.

**z.Ilir Zuka:** Një pyetje, shërbimet e ndriçimit publik dhe dekorimi i qytetit për festat e fundvitit. A është vetëm për qytetin e Vitisë apo edhe për sheshin e Pozharanit, sepse e di që vitin e kaluar, vitin 2020 është rregullu edhe sheshi i Pozharanit, ndërsa në vitin 2021 nuk ka pas asnjë dekorim. Shpresojmë që vitin 2022 mu be prapë

**z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit:** Dekorimi ka qenë vetëm për Vitinë.

Si pikë të tret të rendit të ditës kemi:

**3. Propozim Informatë për planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin 2022**

**z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit:** Edhe këtu e kemi një pasqyrë të planifikimeve sipas të gjitha njësive të autoriteteve, e ku ne e mbajmë një përmbledhje. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E kam një pyetje për këtë: a keni fillu me procedura? Se një pjesë e mjeteve janë vonu për zotim i lëshimit të buxhetit dhe hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit:** Kemi fillu me procedura, 7 procedura i kemi në udhëheqje, 2 jemi tu i prit që është lëshu buxheti muj me i nënshkru të Hënën kontratën. Pyetjet e parashtruara nga Liridona, bini me shkrim edhe dergoi tek Mustaf Mehmeti, ai i përcjellë procedurat.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-731, të datës 24.09.2021 për taksa, ngarkesa dhe gjoba**

**z.Besnik Imeri, drejtor i financave:** Me kërkesën e MAPL-së duhet të behet disa ndryshim plotësime në rregullore. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë urdhëroni.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush? Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë te rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e iniciativës së kryetarit për ndryshim dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011**

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Në aspektin ligjor kërkohet kështu. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë urdhëroni.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të gjashtë te rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisioni për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të shtatë te rendit të ditës kemi:

**7. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e Propozim Vendimit për formimin e Komisionit për procedurat e mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjuetisë në territorin e Komunës së Vitisë**

**z.Naim Pira, drejtor i Drejtori së Bujqësisë:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju uroj punë të mbarë! Në mandatin e kaluar është miratu propozim për themelimin e vendgjuetisë, mirëpo për shkak se nuk ka qenë funksional dhe ka qenë vit zgjedhor, e nuk kemi pas të drejtë me dhanë në shfrytëzim pronën komunale, ne e kemi rikthy propozimin dhe kërkoj miratimin nga ju.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të tetë te rendit të ditës kemi:

**8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi bënë prezantimin e kësaj pike dhe hapi debat. Pasi që nuk pati për diskutim e hodhi në votim të shkoj për miratim në kuvend. Me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të nëntë te rendit të ditës kemi:

**9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Arsim, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi bënë prezantimin e kësaj pike dhe hapi debat. Pasi që nuk pati për diskutim e hodhi në votim të shkoj për miratim në kuvend. Me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të dhjet te rendit të ditës kemi:

**10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2022**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Materialin e keni pranu me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të njëmbëdhjetë te rendit të ditës kemi:

**11. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2022**

**znj. Majlinda Ostrogllava, drejtoreshë e katastrit:** Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Hapi debat. Pasu që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të KPF-së.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

______________

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

______________

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-03-2022
02-035/02-267

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, Udhezimin Administrativ MAPL-05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen e kompotencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM
## PËR EMËRIMIN E KOMITETIT PËR SHENDETESI DHE MIRËQENIE SOCILE

**I.**

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta emëron Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të Komunës së Vitisë.

**II.**

Komiteti ka këtë përbërje:
1. Valentina Mehmeti, anëtare, përfaqësues nga Kuvendi Komunal
2. Sokol Shaqiri, anëtar, përfaqësues nga Kuvendi Komunal
3.
4.
5.

Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ne mbledhjen e pare do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti

**III.**

Komiteti nga neni 1 i këtij propozim vendimi ka për detyrë që të shqyrtoj çështje të cilat kane të bëjnë me gjendej në shëndetësi dhe gjendjen Sociale të banoreve të Komunës së Vitisë dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime për tejkalimin e gjendjes në shëndetësi dhe në mbrojtje sociale, kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i Drejtorisë për shëndetësi dhe Kryesuesi i komitetit më detalish mundet ti përcaktoj detyrat e këtij komiteti.

**IV.**

Anëtarët e Komitetit për shërbime publike të emëruar në neni 1 të këtij propozim vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**V.**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do te kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryesuesi i komitetit

**VI.**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-03-2022
02-035/02-266

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, Udhezimin Administrativ MAPL-05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen e kompotencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM
## PËR EMËRIMIN E KOMITETIT PËR SHERBIME PUBLIKE

**I.**

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta emëron Komitetin për shërbime Publike të Komunës së Vitisë.

**II.**

Komiteti ka këtë përbërje :

1. Basri Sylejmani, anëtar, përfaqësues nga Kuvendi Komunal
2. Taibe Ibrahimi, anëtar, përfaqësues nga Kuvendi Komunal
3.
4.
5.

Komitetin për shërbime publike ne mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti

**III.**

Komiteti nga neni 1 i këtij propozim vendimi ka për detyrë që të shqyrtoj çështje të cilat kane të bëjnë me shërbimet publike për Komunën e Vitisë dhe të jep vërejtje propozime dhe sugjerime për lëmin e shërbimeve publike, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjence dhe Kryesuesi i këtij komitet me detalish mund të përcaktoj detyrat e këtij komiteti.

**IV.**

Anëtarët e Komitetit për shërbime publike të emëruar në neni 1 të këtij propozim vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**V.**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do te kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryesuesi i komitetit

**VI.**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

11-03-2022
02-035/02-268

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, Udhëzimin Administrativ MAPL-05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 50 shkronja 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM

## PËR EMËRIMIN E KOMITETIT PËR PLANIFIKIM, RREGULLIM TË HAPËSIRAVE DHE MBROJTJEN TË MJEDISIT

**I.**

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta emëron Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë.

**II.**

Komiteti ka këtë përbërje

1. Ekrem Ymeri, anëtar, përfaqësues nga Kuvendi Komunal
2. 
3. 
4. 
5. 

Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit ne mbledhjen e pare do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti

**III.**

Komiteti nga neni 1 i këtij propozim vendimi ka për detyrë që të shqyrtoj çështje e planifikimit rregullimit tw hapësirës dhe mbrojtjen të mjedisit dhe të jep vërejtje, propozim dhe sugjerim lidhur me planifikimi, rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e mjedisit për Komune e Vitisë.

**IV.**

Anëtarët Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të emëruar në neni 1 të këtij propozim vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**V.**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do te kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryesuesi i komitetit

**VI.**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

15-03-2022
02-035/02-272

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 18 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020, për transparencë në komuna, nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM

**Për shpalljen në konsultim`publik draft ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Vitisë me nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011**

**Neni 1**

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në konsultim publik draft ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Vitisë me nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011

**Neni 2**

Propozimi në konsultim publik i propozim të draft ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Vitisë me nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, do të jepet në konsultim publik deri me: 30.04.2022. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së konsultimit publik ne zyrën e sekretarisë së Kuvendit Komunën në Komunës të Vitisë ndërtesa e kryetarit zyra nr. 1 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën Fatlum.Demiri@rks-gov.net, dokumenti gjendet në ueb faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

**Neni 3**

Debati publik do të mbahet me datën: 06.05.2022 në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë. Të bashkangjitur me këtë propozim vendim gjeni rekomandimet e komisionit për ndryshim plotësim të Statutit

**Neni 4**

Të drejtë pjesëmarrje në konsultim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

**Neni 5**

